



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENT" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**PSH. nr. 666/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej: Vedat Poterqoi- Kryetar, Kimete Gashi- Anëtare, Agon Ramadani- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) B&D "Engineering" shpk-Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: "Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5", me nr.të prokurimit: KEK-22-6439-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a , me datën 29.12.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. Aprovohet**, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik B&D "Engineering" shpk-Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 16. 11. 2022 me numër protokolli 666/2022 për aktivitetin e prokurimit "Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5", me nr.të prokurimit: KEK-22-6439-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a

**II. Anulohet**, njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5", me nr.të prokurimit: KEK-22-6439-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)- Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

VI. Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues aprovohet si e bazuar, të njëjtit i kthehet tarifa e paguar me parashtrimin e ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **A r s y e t i m**

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale -*

Me datën: 29. 06. 2022, Koorporata Energjitike e Kosoves KEK sh.a në cilësinë e AK-së, ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizimi me pjesë rezervë për valvat kryesore rregullueser furnizimin e kazanit me ujë demi në Bl. A3, A4, A5”, me nr. të prokurimit: KEK-22-6439-1-2-1. Hapja e ofertave: 01.08.2022. Njoftimi mbi vendimin e AK: 27.10.2022. Kërkesa për rishqyrtim me dt. 31.10.2022. Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim me dt. 07.11.2022

OE B&D “Engineering” shpk-Prishtinë si palë e pakënaqur me vendimin e AK për anulim të aktivitetit të lartcekur, me datën 16. 11. 2022, ka parashtruar ankesë në OSHP nr. 666/22 (nr. protokolli).

Me rastin e shqyrtimit paraprak, Paneli Shqyrtues konstatoi se, ankesa në rastin konkret, është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë në OSHP vetëm pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë parashtruesi e ka statusin e palës së interesuar në kuptim të nenit 4, paragrafi 1.26, kurse po ashtu ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar do të thotë se ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave të cituara dhe e njëjta bije nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

*- Vlerësimi dhe administrimi i provave –*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertet vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 dhe 114, të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër i cili me 01. 12. 2022, ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- të aprovohet si e bazuar ankesa e OE ankues, si dhe
- të anulohet njoftimi për anulim të kontratës i AK-së

Autoriteti kontraktues Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur- furnizim, kriteri i dhënjes së kontratës Çmimi më i ulët. Pretendimet kryesore ankimore kanë të bëjnë kundër **anulimit** të aktivitetit të prokurimit dhe eliminimit të ofertës të OE ankues B&D “Engineering” shpk-Prishtinë përkatësisht kundër arsytimit të eliminimit ku AK – Korporata Energjetike e Kosovës /KEK/ sh.a, përmes letrës standarde të datës 25.10.2022, shprehimisht ka potencuar: *“Ne DT Aneksi 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TE DETYRUSHME është kërkuar:*

*1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezerve të valvave kryesore për (12 muaj)për punë normale. OE B&D “Engineering” shpk ka ofrua garancioni nga prodhuesit PERSA dhe ARCA për pjesetë rezervë përveç për pozicionin:*

*5-154573679 Kushineta aksiale (SKF)origjinale për valvat kryesore rregulluese për funizimin e kazanit me ujë demi numri i valvave (1034659;1034660).*

Përgjigje në pretendimet ankimore (Neni 113 LPP) B&D “Engineering” shpk-Prishtinë Ekspertja shqyrtuese/teknik sqaron se për këtë procedurë të prokurimit, AK KEK me datë 25.10.2022 ka nxjerr Njoftim mbi Vendimin e AK-së duke e anuluar këtë procedurë të prokurimit me arsyetimin se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, kurse përmes letrës standarde për tenderuesin e eliminuar e njofton OE ankues se:

*1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezerve të valvave kryesore për (12 muaj)për punë normale. OE B&D “Engineering” shpk ka ofrua garancioni nga prodhuesit PERSA dhe ARCA për pjesetë rezervë përveç për pozicionin: 5-154573679 Kushineta aksiale (SKF)origjinale për valvat kryesore rregulluese për funizimin e kazanit me ujë demi numri i valvave (1034659;1034660).*

Kurse OE ankues me datë 31.10.2022 parashtrohet kërkesë për ri shqyrtim pranë AK-së, duke e kundërshtuar vendimine AK-së për anulim të procedurës, si dhe jep arsyet e kundërshtimit të këtij vendimi si më poshtë:

*Ne kuader te permbushjes se kriterit Pika 1:*

*“1.Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për ( 12 muaj ) për punë normale. ”*

*I jane dorezuar Autoritetit Kontraktor garancionet e leshuara nga 2 prodhuesit me te cilet ne kemi konkuruar ne kete procedure.*

*Saktesisht eshte dorezuar ditën e hapjes se tenderit date 01.08.2022:*

*Garancioni nga prodhuesi “STAHL ARMATUREN PERSTA GMBH” –*

*Garancioni nga prodhuesi “ARCA – REGLER GMBH”*

*Te 2 keta prodhues jane njekohesisht edhe prodhuesit ORIGINAL te pjeseve te valvulave kryesore rregulluese per furnizimin e kazanit me uje demi ne Bl. A3, A4, A5, mallra keto objekt prokurimi ne kete lende.*

*Pra, nga dokumentacioni i dorezuar, i eshte bere me dije AK se oferta e dorezuar nga ne i referohet mallrave te ofertuara nga vetem 2 prodhues (PERSTA dhe ARCA), nuk perfshihet ne oferten tone asnje prodhues i trete, i cili do duhej te dorezonte gjithashtu nje garancion mbi mallrat e ofertuar. Lidhur me këtë kërkesë për ri shqyrtim, AK me datë 07.11.2022 nxjerr vendim sipas kërkesës për ri shqyrtim duke e refuzuar si të pa bazuar kërkesën për ri shqyrtim, me arsyetimin se:*

*AK edhe njëherë konstaton se në DT është kërkuar:*

*Kushsineta aksiale (SKF) origjinake, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660). Copë 2*

*OE B& D ENGINEERING SHG.P.K. ka ofruar garancion nga prodhuesi PERSA dhe ARCA për pjesët rezervë përveç për pozicionin:*

*5-154573679 Kushsineta aksiale (SKF) origjinale, për valvat kryesore rregulluese për furnizimin e kazanit me ujë demi, numri i valvave (1034659; 1034660)*

*Për këtë pozicion OE nuk e ka deklaruar prodhuesin e kushinetës dhe nuk ka vizatim as katalog me përshkrim teknik për këtë kushinetë.*

*Pas shqyrtimit të kërkesave të dosjes së tenderit dhe tenderit të dorëzuar nga OE ankues, ekspertja shqyrtuese/teknik sqaron se OE ankues me tender ka bashkangjitur 2 garancione nga dy prodhues:*

-AK tek Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme qarte specifion kerkesat e veta dhe te njejtat i percakton dhe kërkon garancion per produktet e ofertuara.

Ne letren standarde per sqarimin e tenderit te dates 07.09.2022 AK kerkon nga OE te nenvizohen produktet e ofruara dhe i njehti i pergjigjet me daten 09.09.2022 dhe i nenvizon artikujt te cilet i ka ofertu duke përfshi edhe kushineten SKF tek pozicioni 9.

Duke marrë për bazë garancionin të cekura më lartë që prodhuesi i valvave ka dhënë për të gjithë artikujt e ofertuar konsideroj që i njëjti garancion vlenë edhe për kushinetat SKF të kërkuara. Këtu bazohen edhe në kerkesat që AK i ka kerkuar janë për punë normale dhe kerkesat tjera në vazhdim janë në rast të liferimit.Poashtu garancionet dhe atestet origjinale dorëzohen se bashku me produktet e ofruara.

Megjithatë sipas kërkesës së prezantuar më lartë, AK te pika 1 e Kriterëve teknike që duhet përmbushur e ka cekur “Garancioni i prodhuesit të pjesëve rezervë të valvave kryesore për 12 muaj për punë normale”, ndërsa OE ankues në garancitë e prezantuara më lartë ceket se janë prodhues të gjitha llojeve të valvave si dhe japin garanci 12 muaj për produktet e ofruara. Andaj, ekspertja shqyrtuese/teknik konsideron se pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Në mbështetje të asaj që u përshkrua si më lartë, vlerësimi ynë është se vlerësimi i ofertave nuk është bere ne harmoni me kërkesat kundrejt ofertave, përkatësisht ne harmoni me nenin 59 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin merititor.

Duke i analizuar pretendimet e ankuesit, përmbajtjen e tyre dhe raportin e ekspertit shqyrtues Paneli Shqyrtues konsideron se:

Prandaj Paneli Shqyrtues konsideron se AK nuk ka respektuar dispozitat ligjore të 62 të LPP duke e anuluar aktivitetin e prokurimit në rastin konkret, pa marr ndërmarrë paraprakisht veprime në kuptim të dispozitave të cituara si më sipër të LPP dhe për rrjedhojë nuk është zbatuar në mënyrë e kërkuar një procesi i drejtë për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave që ka pranuar për aktivitetin e prokurimit në këtë rast. Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij Paneli.

Andaj nga te lartcekurat, paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetare e Panelit Shqyrtues  
Kimete Gashi



**KËSHILLË JURIDIKE:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK-së KEK sh.a

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.